Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

21. Konvertimi në valutë të vetme

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht te ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
 - b) garanci bankare;
 - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Lot.1 “Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”

Lot.2 “Filtër Deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitar”

Lot.3 “Materiale të ndryshme konsumi mjekësore”

LOTI NR. 1 – Qese Gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut

N r	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1*	Qese gjaku katërshe top & bottom	Copë	20.000
2*	Qese gjaku treshe	Copë	13.000
3*	Qese gjaku katërshe	Copë	2.000
4*	Qese për prodhimin e trombocitit + sol	Copë	700

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE PER QESE PLASTIKE PER MBLEDHJEN E GJAKUT

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilësinë e gjakut dhe komponentëve të tij, si edhe në Praktikat e Mira Transfuzionale (**GMP**) specifikimet teknike që duhet të plotësojnë qeset e gjakut duhet të jenë si më poshtë:

QESËT PLASTIKE TRESHE, KATËRSHE TE THJESHTA DHE KATËRSHE TOP&BOTTOM

(Te bashkangjitet dokumenti teknik qe provon plotësimin e secilit specifikim teknik.)

1. Sistem qesesh plastike treshe, katërshe te thjeshta dhe katërshe top&bottom për mbledhjen e gjakut të plotë, që mundëson ndarjen në qese satelite të masës eritrocitare, plazmës dhe/ose buffy coat.
2. Volumi i qeses primare duhet të jete i pershtatshëm për të mbledhur 450 ml gjak të plotë, ndërsa qeset satelite duhet të kene një volum 300-400 ml.
3. Qesja primare me 63 ml solucion antikoagulues te tipit CPD.

-
4. Qese satelite me 100 ml solucion SAGM per ruajtjen e eritrociteve per 42 dite.
 5. Qese satelite bosh te pershtatshme per ruajtjen perkatesisht te plazmes ose trombociteve. Në etiketen e qeses duhet te shenohet qe qesja eshte e pershtatshme per ruajtjen e trombociteve deri ne 5 dite.
 6. Qesja duhet të kete transparence te mjaftueshme qe te lejoje ekzaminimin vizual të permbajtjes së saj perpara dhe pas mbledhjes së gjakut.
 7. Age e silikuar, e madhësisë 16G, e pajisur me mbulese dhe mbrojtëse sigurie të integruar për të shmangur shpimet aksidentale pas mbledhjes së gjakut.
 8. Qese e vogël per marrjen e një mostre prej të paktën 30ml - 40ml gjak për analizat e detyrueshme te dhuruesit, përmes një sistemi të tipit Vacutainer te integruar, pa antikoagulant në linjën e marrjes së gjakut. Sistemi duhet të ketë mbështjellëse te ages, të përputhshme me çdo lloj tubi.
 9. Tubi i dhurimit dhe tubi i qeses per marrjen e mostrave duhet te jene te dy te pajisur me mbrojtës mekanik (clamp) me vete, ne mënyrë qe te mos lejohet kalimi ne sistem i sasisë fillestare te dhurimit, te tërhequr ne qesen (xhep). Kjo është mjaft e rëndësishme për te evituar një kontaminim te mundshëm bakterial te gjakut.
 10. Kanula break away duhet te jete e pozicionuar ne linjen e dhurimit mbi konektorin Y.
 11. Prania e segmenteve te kodifikuara në bishtin e qeses së masës eritrocitare (sistemi Top&Bottom) per identifikim dhe gjurmueshmeri maksimale ne marrjen e mostrës nga qesja.
 12. Prania e nje ose disa “oulet ports” ne qeset per ruajtjen e komponentëve te gjakut me mbyllje jo te ringjitshme, te tilla qe te sigurojnë lidhje te sigurt e pa rrjedhje me setin e transfuzionit, edhe gjate përdorimit nen presion.
 13. Rezistencë ndaj centrifugimit (deri në 4000 rpm) dhe temperaturave të ulëta (deri në -80°C).
 14. Qeset duhet te jene te sterilizuara.
 15. Ambalazhimi individual, transparent, rezistent dhe te hapet lehtësisht.
 16. Materiali i qeses duhet te jete plastik PVC, Latex free, apirogjen dhe jo toksik.
 17. Materiali i qeses dhe etiketa duhet te plotësojnë standardet ISO te detyruara 3826 1&2- 2018, 15223-1:2021 dhe ISBT 128.
 18. Etiketa duhet te permbaje informacion mbi:

-datën e skadimit, nr. Lotit dhe serisë se prodhimit;

-emri i solucionit antikoagulant, elementet perberes dhe sasite e tyre;

-emri dhe adresa e prodhuesit;

-temperaturën e ruajtjes.

19. Qeset te përputhen me Rregulloren (BE) 2017/745 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 5 prill 2017 për pajisjet mjekësore, e cila zëvendëson Direktivën 93/42/CE.

-
20. Te shoqërohen me 3 ekstrakore automatike te se njëjtës marke te qeseve, me qellim garantimin e përputhshmërisë se plote për të arritur shkallën më të lartë të automatizimit dhe kohën më të shkurtër të ndarjes. Karakteristikat e ekstraktorëve bashkangjitur.
 21. Te shoqërohen nga aksesore për lehtësimin e manipulimeve gjate procesit te përpunimit: 5 stripera manual dhe 2000 kapëse plastike për tubat e qeseve. Karakteristikat e striper manual bashkangjitur.
 22. Skadimi: jo me pak se 12 muaj, e shënuar ne etiketën e qeses.

QESET PËR PRODHIMIN E TROMBOCITEVE NGA POOL BUFFY-COAT:

1. Volumi: te paktën deri ne 1000 ml.
2. Qese sterile, pa lateks, material plastik i përshtatshëm për ruajtjen e trombociteve.
3. Sistem i mbyllur, i përshtatshëm për lidhjen ne zinxhir te buffy coats dhe solucionit për ruajtjen e trombociteve.
4. Paketim individual, transparent.
5. Materiali i qeses dhe etiketa duhet te plotësojnë standardet ISO te detyruara 3826 1&2- 2018, 15223-1:2021 dhe ISB 128.
6. Data e skadimit dhe numri i lotit të jenë të shënuara qartë në çdo paketim.
7. Qeset duhet të jenë në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/745 për Pajisjet Mjekësore dhe të kenë deklaratë përputhshmërie.
8. Skadimi: jo me pak se 12 muaj, e shënuar ne etiketën e qeses.

SOLUCIONI PER RUAJTJEN E TROMBOCITEVE:

1. Përbërja kimike e përshtatshme për ruajtjen e trombociteve deri ne 7 dite në temperaturë 20-24°C me tundje të vazhdueshme.
2. Volumi: 300 ml±20 ml.
3. Elementet përbërës te përshkruar ne etiketë.
4. Paketim individual, i përputhshëm me sistemet e përgatitjes se trombociteve duke ofruar mundësi për lidhje sterile ne sistem te mbyllur.
5. Certifikim sipas MDR (BE) 2017/745 – Duhet të jetë i aprovuar si një pajisje mjekësore e klasës III (CE/FDA).
6. Duhet të përputhet me standardet ISO 3826-2:2008 për pajisjet për ruajtjen e gjakut dhe përbërësve të tij.
7. Skadimi: jo me pak se 12 muaj, e shënuar ne etiketën e qeses.

EKSTRAKTORET AUTOMATIKE:

1. Përputhshmëri e plote me qeset e ofruara për të arritur shkallën më të lartë të automatizimit dhe kohën më të shkurtër të ndarjes.
2. Te pajisur me sistem saldimi (ngjitje sterile) të integruar.
3. Saldim automatik i tubave pas përfundimit të procedurës.
4. Sistemi me presa të programueshme individualisht (forca e shtrydhjes, vëllimi i buffy coat, etj.).
5. Pajisjet duhet të shoqërohen nga manuali i përdorimit.
6. Instalim, kolaudim dhe trajnim “on site” i punonjësve për përdorimin e pajisjeve. Procedurat të shoqërohen nga procesverbali përkatës.
7. **Mirëmbajtje e pajisjeve:** Sipas udhëzimeve dhe frekuencës së përcaktuar nga prodhuesi (të paktën 1 mirëmbajtje parandaluese në vit), duke përfshirë të gjitha pjesët, ndërrimet dhe materialet e nevojshme. Në fund të çdo procedure mirëmbajtje të plotësohet procesverbali përkatës.
8. **Suport teknik** përgjatë gjithë kohës së përdorimit të pajisjeve: Ndërhyrje teknike të pakufizuara, duke përfshirë të gjitha pjesët dhe ndërrimet e nevojshme.
9. Problemet teknike duhet të zgjidhen brenda 72 orësh pune nga momenti i kryerjes së kërkesës për suport me telefon apo email dhe të shoqërohen me procesverbal përkatës.

STRIPER MANUAL I TUBAVE

1. I projektuar posaçërisht për “stripimin” (zhveshjen) e njëtrajtshëm të tubave të qeseve të gjakut gjatë proceseve të ndryshme të përpunimit.
2. I përshtatshëm për stripimin e tubave të qeseve të ofruara nga OE.
3. I prodhuar nga material cilësor, anti-ndryshk, i lehtë dhe i qëndrueshëm. Lehtësi në pastrim dhe dizajn ergonomik

LOTI NR. 2 – Filtra Deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare

Nr	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1*	Filtra deleukocitar për një njësi	Copë	2.000
2*	Filtra deleukocitar laboratori për një njësi	Copë	2.000
3*	Set deleukocitar + bashkues laborator për masat trombocitare	Copë	1.600

SPECIFIKIME TEKNIKE PER FILTRA DELEUKOCITARE

Filtrat deleukocitare për gjak të plotë dhe koncentrat eritrocitarë për një njësi, duhet të plotësojnë këto kritere:

- Filtër i tipit bed-side (përdoren te shtrati gjatë transfuzionit).
- Performanca e filtrit duhet të jete e tillë që, **numri rrezidual i leukociteve** në masën eritrocitare të jetë $< 5 \times 10^5$ /njësi.
- Të sigurojë ruajtje maksimale të eritrociteve $>90\%$;
- Të ofroje një procedure të thjeshte perdorimi;
- Të mos kete nevoje per shpelarje para/pas filtrimit me saline.
- Sistemi duhet te jete i mbyllur, steril;
- Filtri duhet te ofroje mundesine e perdorimit me flukse te medha gjaku per transfuzionin masiv.
- Filtri duhet te perdoret per njesite e gjakut, deri ne fund te skadences se tyre, si dhe me cdo lloj solucioni aditiv.
- Filtri duhet te jete i pajisur me kamera pikimi te vet nivelueshme, per nje mbushje te shpejte dhe automatike te kamerat pikuese.
- Filtri duhet te jete i pajisur me valvulen e ajrit me filter bakterial per nje drenim sa me te mire pas filtrimit me recovery sa me te mire te eritrociteve.
- Garantim të sterilitetit gjate gjithë periudhes se mbushjes se tij.
- Paketim individual: latex free.
- Gjate perpunimit nuk duhet te jene perdorur ngjites te ndryshem kimike.
- Duhet te jete i pajtueshem me aparatine tone per ngjitjen sterile.

- I lehtë në përdorim dhe me mbushje të realizuar lehtësisht si rezultat i ndikimit të forcës së gravitetit.
- Rregullues të fluksit të tipit “roller clamp”.
- Të ketë Markën CE ose FDA.
- Skadencë: **12 muaj** nga data e lëvrimit.
- **Sasia:** shiko tabelën

Filtra Laboratori: për gjak të plotë dhe koncentrat eritrocitarë, duhet të plotësojnë këto

kritere:

- Filtri Laboratorit duhet të jetë i përshtatshëm për filtrimin e një njësie mase eritrocitare.
- Performanca e filtrit duhet të jetë e tillë që, **numri rrezidual i leukociteve** në masën eritrocitare, të jetë $< 5 \times 10^4$ /njësi.
- Të sigurojë mbushje automatike të filtrit për të garantuar lehtësi maksimale në përdorim.
- Të bëjë filtrim direkt të gjakut, pa qenë nevoja për të bërë mbushje/shplarje paraprake të tij me saline, apo shplarje me salinë pas filtrimit.
- Të ofrojë mundësinë e eliminimit të ajrit dhe qesën për transferimin e eritrociteve.
- Të mund të përdoret si për gjakun e procesuar me sistem të hapur apo edhe të mbyllur.
- Të mund të përdoret për të gjitha llojet e anti – koagulantëve dhe solucionëve aditivë.
- Të ketë një “recovery eritrocitar” jo më pak se 90%.
- Të jetë e pajtueshme për t’u përdorur me ngjitesit sterile në dispozicion.
- Të mos jenë përdorur ngjites kimike gjatë prodhimit të filtrave.
- Të ketë Markën CE ose FDA.
- Paketim individual dhe të jenë të sterilizuara. Ofertuesit duhet të përshkruajnë saktë metodën e sterilizimit të përdorur.

-
- Skadenca: **12 muaj** nga data e lëvrimit.
 - **Sasia:** shiko tabelën.

Afati i levrimit:

Sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Duke filluar menjehere pas lidhjes se Marreveshjes Kuader me afat 12 (dymmbedhete) mujor.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE PER SETE DELEUKOCITAR + BASHKUES LABORATORI
PER MASAT TROMBOCITARE**

Të gjitha qeset e këtij seti të jenë të lidhur nepermjet tubave plastik, material PVC, apirogen dhe jo-toksik.

Seti të jetë i përbërë nga :

1. Tuba bashkimi plastik që mundesojnë lidhjen sterile deri ne 6 qese me trombocite
2. Tubat plastike të jenë të pajisur me kapse plastike (clamp)
3. Seti të jetë i përshtatshëm për bashkimin e trombociteve tek të prodhuar me sistemin Reveos (ose ekuivalent), me filtër in-line të përshtatshem për filtrimin e pool-it të trombociteve me gravitet.
4. Filtri in-line të ketë karakteristikat si më poshtë:
 - Eficencë filtrimi $<0.1 \cdot 10^6$ leukocyte residual
 - Rekuperimi i PLT mbi 90%
 - Koha e filtrimit jo më gjatë se 8-10min
5. Kapse plastike (clamp) për linjen e bashkimit (pool-ing)
6. Qese të vogël (in-line) për marrjen e mostrave për kontrollin e cilësisë nga qesja kryesore.

Paketimi: Të jenë të paketuara me sistem te mbyllur individual (vec e vec). Materiali paketues duhet te jete rezistent ndaj faktoreve te mjedisit sidomos ndaj lageshtires dhe te hapet lehtesisht pa kerkuar paisje te vecanta per kete.

Modeli i filtrave dhe setit deleukocitar + bashkues laboratorit per MT të ofruar nga firmat perkatese, me te gjitha elementet e kerkuara ne këto specifikime, duhet t'i paraqitet komisionit paraprakisht.

LOTI NR. 3 – MATERIALE TE NDRYSHME KONSUMI MJEKESORE

Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1*	Tuba vakutainer me xhel	Copë	50,000
2A*	Tuba vakutainer me K3 EDTA – 8-10ml	Copë	55,000
2B*	Tuba vakutainer K3 EDTA – 4-5ml	Copë	80,000
3*	Age vakutainer 21G	Copë	5,000
4	Pipeta plastike 1ml	Copë	90,000
5	Tuba plastik 12X75mm	Copë	100,000
6	Tuba seroteke 2ml	Copë	52,000
7	Leucoplast 2,5 cm x 5 m	Copë	800
8A	Doreza laboratorit josterile	Copë	130,000
8B	Doreza laboratorit (nitrili)	Copë	50,000
9	Alkool 96°	Litra	500
10	Pambuk 100 gr	Pako	1,000
11	Bende elastike me vetëngjitje 8m x 4cm	Copë	10,000
12	Zhgute me kapse për krahun e dhuruesve	Copë	100
13	Letra Filtri 50*50	Copë	40,000
14	Age të thjeshta të vogla	Copë	15,000
15	Jod (Betadine Alkoolike 5-10%)	Litra	45

16	Aparate tensioni	Copë	20
17	Stativ për tuba seroteke	Copë	80
18	Ankerplast	Copë	2,000
19	Shiringa 10ml	Copë	1,000
20	Garza sterile	Copë	50,000
21	Lanceta	Copë	20.000

SPECIFIKIME TEKNIKE PER DISA MATERIALE KONSUMI

Tubat vakutainer ndahen si më poshtë:

➤ **Tuba me xhel** të përshtatshem për ndarjen e serumit, me këto specifikime:

- Volumi 8-10 ml; 16x100mm
- Sistem i mbyllur me vakum, me etiketë mbi tub;
- Të kenë tap gome të sheshte me mbyllje hermetike, dhe tapa te kete trashesine e duhur per shpimin dhe marjen sa me lehte te mostres nga sampling pouch i qeses se gjakut me age vacutainer, që do të thotë jo më e trashë se 15 mm.
- Të jenë sterile.
- Skadencë jo më pak se **12 muaj**.

Sasia: shiko tabelën

➤ **Tuba me K3 EDTA.**

- Volumi, jo më pak se 7 ml; 16x100mm
- Sistem i mbyllur me vakum, etiketë mbi tub
- Të jenë me tape gome me mbyllje hermetike
- Të jenë sterile.
- Skadencia jo më pak se **12 muaj**

Sasia: shiko tabelën

➤ **Tuba me K3 EDTA**

- Volumi, jo më pak se 4 ml; 13x75mm
- Sistem i mbyllur me vakum, etiketë mbi tub;
- Të jenë me tape gome me mbyllje hermetike;
- Të jenë sterile.

Skadenca jo më pak se **12 muaj**

Sasia: shiko tabelën

➤ **Tuba cilindrik polystyreni, jo-sterile 12x75mm - 5ml (PS test tubes 12x75mm)**

Të jenë transparent në pamje e me fund të rrumbullaket, të pershtatshem per testime të ndryshme laboratorike (një perdorimesh).

Sasia: shiko tabelën

Tuba seroteke

1. Volumi 2ml
2. Të jenë të pershtatshem per ruajtje ne -80°C
3. Të kenë vend të pershtatshem për shkrim
4. Të sigurojnë mbyllje hermetike, me filetim.

Sasia: shiko tabelën

Stativë për tuba seroteke

1. Të jenë te pershtatshem per ruajtje në -80°C
2. Kapaciteti ruajtes i nje stativi te jete jo me pak se 80 tuba
3. Të jenë plastike dhe me kapak me siguresë
4. Te autoklavueshem

Sasia: shiko tabelën

Doreza laboratorike jo-sterile

Dorezat duhet të jenë 100% latex, për përdorim spitalor dhe me pudër me përmasa si më poshtë:

- 80% e sasisë e masës M
- 20% e sasisë e masës S

Sasia: shiko tabelën

Doreza laborator (Nitrili), jo-sterile

Dorezat duhet të jenë një përdorimshe, pa pudër, me përmasa si më poshtë:

- 80% e sasisë, e masës S
- 20% e sasisë, e masës M

Sasia: shiko tabelën

Leukoplast (2.5cmx5m)

Të jetë për përdorim spitalor e me paketim individual, për të shmangur tharjen e parakohëshme e për rrjedhojë humbjen e aftësisë ngjitëse të tij.

Sasia: shiko tabelën

Bende elastike (auto-adezive)

Të jenë të përshtatshme për lidhjen e krahut të dhuruesit pas dhurimit të gjakut.

Të jenë në paketime individuale dhe me përmasa 8cm x 4m.

Sasia: shiko tabelën

Betadinë Alcooolique 5-10% (Povidone Iodée Ethanol)

Solucion për aplikim kutan si dezinfektant për vendin e venopunkturës të krahut të dhuruesit

Sasia: shiko tabelën

Aparat tensioni elektronik

- Të jetë i pajisur me ekran të madh digital LCD, ku të shfaqen përveç vlerave të matjes edhe data, ora e matjes
- Të bëjë matjen e TA/Ritmi zemres/Pulsi (40-210/min)
- Të punojë me bateri si dhe të ketë edhe fishe karikimi
- Të ketë memorie ruajtje për të paktën 10 matjet e fundit
- Rripi i dorës jo më i vogël se 32mm
- Të mos ndikohet nga temperaturat dhe lagështia e ambientit

Sasia: shiko tabelën

Zhgut elastik me kapse plastike

- Rrip i lastikut i sheshtë (pa latex) jo më i shkurtër se **50cm**, i plotë/trashë për elasticitet më të mirë, me gjerësi 2.0-2.5 cm dhe trashësi 1mm.
- Kapse plastike ABS me buton për lirimin automatik të shtypjes. E fortë, rezistente nga përdorimet e shumta.
- Të ketë markën CE

Lanceta një-përdorimëshe

1. Lancetat duhet të kenë mekanizëm shkrepjeje për shpimin.
2. Të jetë e pajisur me kapak sigurie që rrotullohet dhe/ose tërhiqet lehtë.
3. Të ketë një gjatësi 1.85-2.25 mm dhe trashësi 21G.
4. Të jenë të sterilizuara me rreze gama.

Garza sterile për dezinfektim (një-përdorimëshe)

1. Garzat të jenë në paketime individuale, sterile (jo më shumë se 10 garza për paketim).
2. Secila garza duhet të jetë me të paktën katër shtresa.
3. Permasat e Garzave të jenë 8-12cm x 8-12cm
4. Materiali i garzës të jetë 100% pambuk.
5. Të jenë të sterilizuara me EO (Etilen Oksid)

Afati i levrimit: Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Duke filluar menjëherë pas lidhjes së Mëveshjes Kuader me afat 12 (dymbëdhjete) mujor.

LOTI NR.4

“ Sete për REVEOS, inaktivizimin viral të trombocitave MIRASOL dhe aksesori ngjites për TSCD II”

Nr	EMERTIMI	NJESI A	SASIA
1*	Sete për përpunimin automatik të gjakut të plotë	Copë	8 514
2*	Aksesorë ngjites	Copë	22.050
3*	Sete për inaktivizimin viral të masave trombocitare	Copë	1 700

SPECIFIKIMET TEKNIKE

PER SETE TE PERPUNIMIT AUTOMATIK TE GJAKUT TE PLOTE

REVEOS SYSTEM

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilësinë e gjakut dhe komponenteve të tij, si edhe në Praktikat e Mira Transfuzionale (**GMP**) specifikimet teknike që duhet të plotësojnë seti i qeseve për përpunimin automatik të gjakut të plotë, duhet të jetë si më poshtë:

Të përgjithshme:

1. Set qese plastike për përpunimin e gjakut të plotë, të përshtatshëm për të operuar me **Sistemin Automatik REVEOS – set** (ose ekuivalent).
2. Qesja primare, për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut të plotë deri në tre komponente të tij (ME, PFN dhe Trombocite). Perberja e saj të jete prej materiali plastik të thjeshtë – PVC, apirogen dhe jo toksik. Të jete rezistente gjatë procesit të përpunimit (centrifugimit). Po kështu edhe qeset satelite (bosh) të jenë të përshtatshme për prodhimin dhe ruajtjen e komponenteve që përkasin të gjakut.
3. Volumi i qeses primare duhet të jetë 450 ml \pm 10%, si dhe 63 ml antikoagulant (CPD), ndërsa qeset e tjera satelite duhet të kenë një volum prej rreth 500-600ml.

Seti qeseve duhet të përmbajë gjithashtu:

- a. Përveç tre qeseve në të cilat do të kryhet ndarja përfundimtare e nën -produkteve të gjakut (secila me volum 500-600ml), të ketë dhe një qese të vogël (rreth 50-70ml) për devijimin e leukociteve. Të gjitha qeset e këtij seti duhet të jenë të lidhura nepermjet tubave plastike, pra në një sistem të mbyllur.
 - b. Tubat plastike të jenë të pajisur me kapse plastike (clamp) si dhe mbyllje sigurie të brendshme (që thyen përpara përdorimit).
 - c. Ndërmjet qeses kryesore dhe qeses për ruajtjen e eritrociteve (ME) të ketë një filter de/leukocitar për filtrimin e leukociteve.
 - d. Qese të vogël (in-line) për marrjen e mostrave për kontrollin e cilësisë nga qesja kryesore. Kjo të jete e pajisur me agje vakutainer për të lehtësuar marrjen e saj edhe për kontrollin e ngarkesës mikrobike të produktit.
4. **Paketimi:** Të jenë të paketuara me sistem të mbyllur individual (vec e vec). Materiali i paketues duhet të jete rezistent ndaj faktoreve të mjedisit sidomos ndaj lagështirës dhe të hapet lehtësisht pa kërkuar pajisje të vecanta për këto.
 5. **Etiketimi:** Materiali i etiketes së setit të qeseve të ketë perberje PVC. Boja e përdorur për përkatitjen e etiketes nuk duhet të difuzojë nepermjet materialit plastik në brendësi të qeses. Shkrimi duhet të jete i qartë dhe të mbetet i lexueshëm deri në datën e skadencës.

Etiketa e qeses së gjakut duhet të jete e qëndrueshme gjatë përpunimit dhe të përmbajë

edhe këto të dhëna:

-nr.lotit dhe serise së prodhimit;

-emri dhe adresa e prodhuesit;

-temperaturën e ruajtjes

6. Skadenca duhet të jetë **jo më pak se 12 muaj** dhe kjo të jetë e shënuar në etiketën e qeses ose në ambalazhin individual të saj.

Të vecanta:

